



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# GRATË NË EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM

## MËSIMET E NXJERRA NGA KOSOVA

**Botues:** Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**Autore:**

Rudinë Jakupi  
Vesë Kelmendi

**Redaktorë të brendshëm:**

Florian Qehaja  
Skënder Perteshi

**Redaktor i jashtëm:**

Shpend Kursani

Janar 2017

Raporti origjinal është i shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale janë të mbrojtura me Ligjin Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe Ligjin Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çdo formë ose me çdo mjet, elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen para-prake të botuesit.

Ky projekt u përkrah përmes Fondit Think Tank për Evropë më të gjerë - me grant të Iniciativës së Shoqërisë së Hapur për Evropën. Pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Fondit Think Tank për Evropë më të gjerë - Iniciativës së Shoqërisë së Hapur për Evropën.



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# **GRATË NË EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM**

## **MËSIMET E NXJERRA NGA KOSOVA**

Janar 2017  
Prishtinë

# PËRMBAJTJA

GJETJET KRYESORE .....	5
1. HYRJE .....	7
2. METODOLOGJIA .....	9
3. KONTEKSTI I RADIKALIZIMIT TË GRAVE NË KOSOVË .....	10
4. FAKTORËT DHE NDIKIMET E JASHTME DHE TË BRENDSHME .....	13
4.1. Faktorët ideologjikë .....	15
4.2. Arsimi dhe punësimi .....	17
4.3. Familja dhe kushtet e tjera sociale .....	18
5. REKRUTIMI (GRATË DHE FËMIJËT) .....	19
5.1. Gratë dhe vajzat që kanë migruar me burrat/familjet e tyre .....	21
5.2. Jeta në Siri dhe Irak për gratë kosovare .....	23
6. GRATË SI PARANDALUESE TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM .....	26
7. KONKLUZIONE .....	28
8. REKOMANDIME .....	29
BIBLIOGRAFIA .....	31

## GJETJET KRYESORE

### Konteksti

- Në mesin e të paktën 4000 luftëtarëve të huaj nga Evropa Perëndimore që u janë bashkuar organizatave ekstremiste të dhunshme në Siri dhe Irak, më shumë se 700 janë femra.
- Më shumë se 40 gra që u janë bashkuar grupeve ekstremiste të dhunshme në konfliktet e Sirisë dhe Irakut janë nga Kosova. Në perspektivë krahasuese me rajonin e Ballkanit Perëndimor, ky numër renditet vetëm pas atij të Bosnjës dhe Hercegovinës, nga ku 60 gra janë raportuar të jenë përfshirë në konfliktet në Siri dhe Irak.
- Nuk mund të flitet për “luftëtare të huaja kosovare” si një kategori e veçantë, pasi ky raport konstaton rrugë shumë të ndryshme të ndërmarra nga gratë ekstremiste dhe potencialisht ekstremiste në Kosovë. Së pari, ka gra të martuara të që vullnetarisht janë përfshirë në konflikt - duke thyer stereotipin që i portretizon si viktime të martesës dhe burrave të tyre. Së dyti, ka raste të grave që vendosën të mos përfshihen në konflikt, edhe pse kanë përjetuar trysni nga burrat ose partnerët e tyre pjesëtarë në organizatat ekstremiste. Së treti, raporti konstaton se ka edhe raste të grave që si pasojë e drejtpërdrejtë e varësisë së tyre nga familjet dhe burrat e tyre, janë detyruar të përfshihen në konfliktin e Sirisë dhe Irakut.
- Ky hulumtim ka gjetur edhe raste të grave të kthyer që ende besojnë se vendimi i tyre për t’iu bashkuar organizatave ekstremiste të dhunshme ishte i drejtë, duke e interpretuar si detyrim që buron nga shkrimet e shenjta Islame.
- Rrëfimet tregojnë se disa gra nga Kosova kanë qenë aktive edhe në rekrutimin e grave të tjera për t’u përfshirë në konfliktet e Sirisë dhe Irakut.
- Propaganda e ISIS-it i konsideron gratë si nëna që do të rrisin brezin e ardhshëm të xhihadistëve, dhe e kufizon rolin e tyre në jetën shtëpiake, mësimdhënie dhe si motra medicianle në disa raste.
- Gjatë qëndrimit të tyre në territorin e mbajtur nga ISIS (ndoshta edhe grupe të tjera ekstremiste), gratë nga Kosova u përmbahen roleve dhe normave tradicionale gjinore. Nuk i sheh njeri jashtë shtëpive dhe detyrat e tyre janë të kufizuara në jetën familjare (kryesisht gatim, pastrim dhe kujdesi për fëmijët e tyre).
- Gratë kosovare nuk kanë qenë pjesëmarrëse aktive në organizatat e dhunshme ekstremiste. Nuk i kanë lejuar as të marrin pjesë në luftime, as të mbajnë armë.

## Faktorët e jashtëm dhe të brendshëm

- Ka një sërë arsyesh që shtyjnë gratë nga Kosova për t'u përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, të cilat përgjithësisht përfshijnë faktorët ideologjikë, faktorët socio-ekonomik dhe motivet personale.
- Statistikat tregojnë se gratë janë të diskriminuara pothuajse në çdo sferë të jetës publike. Krahasuar me burrat, gratë janë të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e institucioneve dhe procesit të vendim-marrjes. Edhe papunësia është më e lartë mes grave.
- Ky diskriminim i përgjithshëm shoqëror reflektohet edhe brenda strukturave të Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK). Ky hulumtim tregon se përfaqësimi i grave brenda strukturave të BIK-ut qëndron pak më mirë vetëm në Prishtinë, ndërsa në qytetet dhe komunat e tjera më të vogla, në përgjithësi, mungon përfshirja e grave brenda strukturave të tyre udhëheqëse.

### *Arsimi, diskriminimi social dhe motivet personale*

- Ky raport nuk mund të krijojë ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë midis nivelit të arsimit ose gjendjes së punësimit dhe fenomenit të përfshirjes së grave në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Për shembull, ka gra nga Kosova që janë përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, të cilat ishin të punësuar dhe kishin diploma universitare në kohën e nisjes. Ka edhe nga ato që nuk kishin as diplomë universitare, e as nuk ishin të punësuar para nisjes.
- Raporti konstaton se një tjetër faktor që ka ndikuar tek gratë për t'u përfshirë vullnetarisht në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, është ndjesia e të qenurit e diskriminuar mbi baza fetare dhe përjashtimi nga institucionet, veçanërisht nga Bashkësisë Islame e Kosovës (BIK).
- Një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar tek gratë për t'u përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut është propaganda nga partnerët/burrat e tyre.
- Shumica e këtyre grave kanë përjetuar ngjarje traumatike gjatë jetës (hum-bjen e një të dashuri, kryesisht një ose të dy prindërve dhe ngjarje të tjera të dëmshme), dhe janë martuar në moshë mjaft të re.

---

## 1. HYRJE

---

Historikisht, gratë kanë qenë më shumë viktime sesa ushtruese të dhunës. Situata po ndryshon gradualisht në kontekstin e globalizimit dhe sfidave të reja të sigurisë. Kohët e fundit ne jemi dëshmitarë të një një rritje të përfshirjes së grave në organizatat e dhunshme ekstremiste, duke përfshirë pjesëmarrjen në konfliktet e huaja. Këto organizata - shpesh të bashkuara rreth një ideologjie të përbashkët politike apo fetare - përfaqësojnë një nga kërcënimet e shumta rishtarë dhe komplekse ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në mënyrë që të krijohet një përgjigje efektive ndaj këtij problemi, është e rëndësishme që fillimisht të përshkruhet pse gratë, gjithnjë e më shumë, lidhen me organizata të dhunshme ekstremiste, dhe cili është roli i tyre në kuadër të këtyre grupeve.

Hulumtimet dhe përvoja aktuale kanë treguar se gratë mund ta ndihmojnë ose ta mbështesin ekstremizmin e dhunshëm, si dhe të jenë viktime të tij, të kundërveprojnë dhe ta parandalojnë atë. Rolet dhe përvojat e tyre nuk janë të njëjta, por mjaft të ndryshme dhe të formësuara nga konteksti, komuniteti dhe historia.<sup>1</sup> Gratë, megjithëse paraqiten si agjente pasive, kanë marrë pjesë në organizatat e reja terroriste më shpesh dhe në mënyra të ndryshme. Gratë kanë marrë pjesë në organizata terroriste si kujdestare dhe ofruese kujdesi; ato kanë promovuar ideologjitë ekstremiste të dhunshme dhe kanë rekrutuar gra të tjera për t'u bashkuar me grupet e dhunshme ekstremiste. Për më tepër, ka burime që lënë të kuptohet se në disa raste gratë kanë marrë armët dhe janë duke luftuar në terren.<sup>2</sup>

Qëllimi i këtij hulumtimi është të hedhë dritë mbi gratë nga Kosova pjesëmarrëse në organizatat e dhunshme ekstremiste dhe pasojat e mundshme që rrjedhin nga roli i tyre. Teksa raporti do të fokusohet vetëm në Kosovë, do të sjellë njohuri ndërkombëtare në trajtimin e këtij fenomeni, duke pasur parasysh se Kosova nuk shënon asnjë përjashtim të përgjithshëm në krahasim me vendet e tjera. Qëllimi është që në veçanti të identifikohen kush janë këto gra, pse marrin pjesë në këto konflikte, dhe cili është roli i tyre.

---

1 Gratë dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm, Dokument përmbledhës dhe Analizë - 27.10.2014, Universiteti Georgetown dhe Misioni i Përhershëm i Emirateve të Bashkuara Arabe në OKB, NY.

2 Burke.J. "Rekrutët e grupeve militante islamike ka të ngjarë të jenë të arsimuar mirë, sipas hulumtimit", The Guardian, 05/10/2016. Qasur më 24/10/2016 - [https://www.theguardian.com/world/2016/oct/05/islamic-state-recruits-world-bank-study-education-boko-haram?CMP=Share\\_iOSApp\\_Other](https://www.theguardian.com/world/2016/oct/05/islamic-state-recruits-world-bank-study-education-boko-haram?CMP=Share_iOSApp_Other)

Gjithashtu shih: Finn Church Aid. "Prova të reja: Fqinjët, jo Imamët radikalë, rekrutojnë luftëtarët e Boko Haram" 3.10.2016, qasur në: <https://www.kirkonulkomaanapu.fi/en/latest-news/news/new-evidence-friends-not-firebrand-imams-recruit-fighters-to-boko-haram/>

Raporti, ndër të tjera, konstaton se ka një grup faktorësh shtytës dhe tërheqës, që i nxisin gratë nga Kosova për t'u bashkuar me këto organizata. Këto motive përfshijnë faktorët ideologjikë dhe socio - ekonomikë, motivet personale dhe joshjen nga rekrutuesit. Teksa shumica e grave që janë bashkuar në organizatat e dhunshme ekstremiste shihen si viktimat dhe jo dhunuese, është gjithashtu e vërtetë se ka gra që e shohin si fuqizim përfshirjen në konfliktet në Siri dhe Irak. Thënë kjo, gjetje të tjera të ndryshme tregojnë se grupet e dhunshme ekstremiste i kanë shfrytëzuar gratë për një sërë aktivitetesh, duke përfshirë logjistikën, rekrutimin, mbrojtjen politike, operacionet, luftimet dhe kohët e fundit sulme vetëvrasëse<sup>3</sup>.

Profilat e grave që i janë bashkuar konflikteve në Siri dhe Irak nga Kosova ndryshojnë, dhe arsye të ndryshme qëndrojnë pas pjesëmarrjes së tyre në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak. Është shumë e vështirë që këto gra të trajtohen si një kategori ose profil i vetëm dhe i veçantë, pasi arsyet për nisjen e tyre për në konfliktin e Sirisë dhe Irakut janë të ndryshme dhe në të shumtën e rasteve varen nga rrethana dhe kontekste sociale të veçanta. Nuk mund të konkludojmë në mënyrë të vendosur se të vetmit faktorë që ndikojnë në vendimin e tyre për t'u përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut janë socio-ekonomikë, pasi kemi parë raste të grave që janë të mirë-arsimuara dhe të mirë-informuara, pavarësisht nga fakti se disa nga këto gra me dëshirë dhe vetëdije kanë vendosur të shkojnë në zonat e konfliktit.

Struktura e raportit është si vijon: pjesa e parë e raportit fillon duke elaboruar kontekstin e përgjithshëm të pjesëmarrjes së grave kosovare në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak. Kjo pjesë jep disa statistika përshkruese dhe jep kontekstin e çështjes së radikalizimit të grave në Kosovë. Më pas, raporti përpiqet të ofrojë shpjegimin e disa faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm që kanë ndikuar radikalizimin e grave kosovare dhe nisjen për në konflikt. Raporti vazhdon duke diskutuar mënyrat dhe metodat e rekrutimit të grave dhe vajzave të reja. Gjithashtu, ofron një diskutim në lidhje me jetën e përditshme të grave kosovare në Siri dhe Irak. Para se të përfundojë, raporti shtjellon mënyrat se si gratë mund të veprojnë si parandaluese të ekstremizmit të dhunshëm. Së fundi, raporti jep konkluzione dhe rekomandime si të vazhdohet dhe të trajtohet kjo çështje nga këndvështrime të ndryshme dhe grupet e interesit.

3 Cragin. K. dhe Daly. S. "Gratë si terroriste". Oxford, England, 2009 në Saltman. E. dhe Melanie. S. "Deri sa martirizimi të na ndajë - çështjet gjinore dhe fenomeni ISIS", Instituti për Dialog Strategjik, 2015, f. 4



---

## 2. METODOLOGJIA

---

Për qëllim të këtij studimi, hulumtimi përdor metoda të caktuara cilësore dhe sasimore - edhe pse është bazuar kryesisht në shqyrtimin cilësor. Janë kryer shqyrtimi i literaturës, punë kërkimore/dokumentim, intervista të hollësishme dhe vëzhgime.

Janë kryer dy intervista të hollësishme me gratë që janë janë përfshirë në konfliktet në Siri dhe Irak. Për më tepër, u krye një intervistë me një grua të dyshuar për pjesëmarrje në organizata të dhunshme ekstremiste, dhe një intervistë me një grua, burri i së cilës është përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Këto intervista kanë qenë të vazhdueshme për një periudhë prej katër muajsh, mes shtatorit 2016 dhe dhjetorit 2016. Në mënyrë që, fillimisht, të identifikohet objektivi i këtij hulumtimi, QKSS mblodhi dhe strukturoi informacionet nga burimet e hapura, si media të ndryshme dhe portale të ndryshme të lajmeve. Hulumtuesit e QKSS-së u takuan me të intervistuarit më shumë se një herë.

Për më tepër, janë zhvilluar intervista formale dhe informale me imamë të ndryshëm, përfaqësues të komunave të ndryshme të Kosovës, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, pjesëtarë të Policisë së Kosovës, përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) dhe përfaqësues të departamentit të grave në BIK. Në total, janë zhvilluar shtatë intervista me përfaqësuesit e bashkësisë myslimane në Kosovë dhe përfaqësues të institucioneve qeveritare në nivel qendror dhe lokal.

Analiza e përmbajtjes është përdorur gjerësisht. Raporte të shumta dhe artikuj akademikë janë analizuar me qëllimin kryesor për të gjetur shpjegime të mundshme për fenomenet e radikalizimit të grave në përgjithësi. Për më tepër, është përdorur analiza e përmbajtjes për të kuptuar dhe analizuar shkaqet e radikalizimit të grave në vende të tjera si Bosnja e Hercegovina, Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia.

Ky hulumtim ka disa kufizime që duhet të diskutohen. Gjatë hulumtimeve tona kemi hasur disa vështirësi në sigurimin e qasjes tek personat që janë kthyer nga konflikti i Sirisë dhe Irakut. Edhe pse numri i intervistave është mjaft solid, për qëllimet e këtij studimi nuk na u siguroa qasja në burgje për të kryer intervista, sepse kërkesa jonë për ta bërë këtë është mohuar nga Ministria e Drejtësisë. Megjithatë, raporte të ndryshme, artikuj akademikë dhe të intervistuar të tjerë kanë dhënë informacion dhe të dhëna të mjaftueshme për qëllimin e këtij raporti.

### 3. KONTEKSTI I RADIKALIZIMIT TË GRAVE NË KOSOVË

Numri i luftëtarëve të huaj nga vendet perëndimore të cilët u janë bashkuar grupeve të ndryshme ekstremiste në Siri dhe Irak deri në vitin 2016 vlerësohet të jetë më shumë se 4000, nga të cilët më shumë se 700 janë gra.<sup>4</sup>

Sipas disa raporteve për vendet e Ballkanit Perëndimor, më shumë se 900 persona kanë shkuar në konfliktin e Sirisë dhe Irakut.<sup>5</sup> Këta luftëtarë janë kryesisht nga vende si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia. Janë rreth 300 qytetarë nga Kosova që janë përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut mes vitit 2012 dhe fillimit të vitit 2016, nga të cilët 44 janë gra ose 14% krahasuar me numrin e përgjithshëm të luftëtarëve të huaj nga Kosova. Ka edhe 27 fëmijë nga Kosova.<sup>6</sup> Në Bosnjë dhe Hercegovinë vlerësohet se ka 188 burra, 60 gra ose 18% krahasuar me numrin e përgjithshëm të luftëtarëve, dhe 81 fëmijë të përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut.<sup>7</sup> Nga Maqedonia janë përfshirë 110 persona në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, nga të cilët 3 ose 2.7% janë gra dhe vetëm 3 kanë marrë familjet e tyre në Siri.<sup>8</sup> Nga Shqipëria vlerësohet se ka 150 luftëtarë, nga të cilët 29 janë gra ose 19% në krahasim me numrin e përgjithshëm të luftëtarëve nga Shqipëria. Nga Serbia vlerësohet se ka rreth 50 pjesëmarrës në konfliktin e Sirisë/Irakut, prej të cilëve 10 janë gra ose 20% të numrit të përgjithshëm. Numri i grave nga rajoni i Ballkanit Perëndimor që janë përfshirë në konfliktin e Sirisë/Irakut është paraqitur në tabelën 1 më poshtë. Kjo tabelë shërben për të krahasuar numrin e grave që janë përfshirë në konfliktet e Sirisë dhe Irakut.

4 Qendra Ndërkombëtare për Kundër - Terrorizëm. "Fenomeni i luftëtarëve të huaj në Bashkimin Evropian. Profilet, Kërcënimet dhe Politikat", prill 2016, f. 4. Qasur në: [https://www.icct.nl/wp-content/uploads/2016/03/ICCT-Report\\_Foreign-Fighters-Phenomenon-in-the-EU\\_1-April-2016\\_including-AnnexesLinks.pdf](https://www.icct.nl/wp-content/uploads/2016/03/ICCT-Report_Foreign-Fighters-Phenomenon-in-the-EU_1-April-2016_including-AnnexesLinks.pdf)

5 Azinovic. M. dhe Muhamet. J. "Joshja e re e luftës siriane - kontingjenti boshnjak i luftëtarëve të huaj", Iniciativa Atlantike, Prill 2016, fq. 11 dhe

Selimi. K. dhe Filip. S. "Vlerësimi i përpjekjeve të Maqedonisë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, pamja sipas shoqërisë civile", Analytica, 2016. [http://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web\\_ceb98.pdf\\_pg.10&](http://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf_pg.10&)

6 Fatos Makolli, Intervistë, 27.09.2016, qasur në: <https://www.youtube.com/watch?v=JvhLCriZHaM>

7 Joshja e re e luftës siriane - kontingjenti boshnjak, 2016 fq. 11

8 Selimi. K. dhe Filip. S. "Vlerësimi i përpjekjeve të Maqedonisë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, pamja sipas shoqërisë civile", Analytica, 2016, fq. 10 [http://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web\\_ceb98.pdf](http://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf)

Vendet në BP	Popullsia e përgjithshme	Numri i popullsisë myslimane	Numri i grave pjesëmarrëse në konfliktin e Sirisë/Irakut	Përqindja e grave pjesëmarrëse në konfliktin e Sirisë/Irakut, në krahasim me numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve në konfliktin e Sirisë/Irakut
Shqipëri	2.774.000	2.601.000 <sup>9</sup>	13-29 <sup>10</sup>	19%
Bosnja dhe Hercegovina	3.871.000	1.564.000 <sup>11</sup>	60 <sup>12</sup>	18%
Kosovë	1.824.000	1.660.598 <sup>13</sup>	44 <sup>14</sup>	14%
Maqedonia	2.107.000	713.000 <sup>15</sup>	3 <sup>16</sup>	2,7%
Serbia	7.164.000	280.000 <sup>17</sup>	10 <sup>18</sup>	20 %

**Tabela 1. Numri i grave nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, pjesëmarrëse në konfliktin e Sirisë/Irakut<sup>19</sup>**

Sipas Policisë së Kosovës, vetëm 7 gra janë kthyer në Kosovë nga konflikti i Sirisë/Irakut<sup>20</sup>, por aktakuzë ka vetëm kundër njëres, dhe ajo po pret dënimin. Gjashtë

9 Popullsia myslimane sipas vendeve, qasur në: <http://www.pewforum.org/2011/01/27/table-muslim-population-by-country/>

10 Spahiu. E. "Luftëtarët e huaj, radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor", fq. 57 - 87, 2015, qasur në: [http://www.filipejdos.com/Public/Uploads/Attach/jurekovic\\_and\\_ejdos\\_2016\\_violent\\_extremism\\_579f5bba2729b.pdf](http://www.filipejdos.com/Public/Uploads/Attach/jurekovic_and_ejdos_2016_violent_extremism_579f5bba2729b.pdf)

11 Ibid

12 Iniciativa Atlantike "Joshja e re e luftës siriane - kontigjenti boshnjak i luftëtarëve të huaj"<sup>2016</sup>

13 Gazeta Tema "Regjistrimi i popullsisë, 96% të kosovarëve janë myslimanë", qasur në: <http://www.gazetatema.net/web/2012/02/09/regjistrimi-i-popullsisë-96-e-kosovareve-jane-myslimane/>

14 Fatos Makolli, Intervistë në Rubikon, 27.09.2016, qasur në: <https://www.youtube.com/watch?v=JvhLcziZHaM>

15 Popullsia myslimane sipas vendit <http://www.pewforum.org/2011/01/27/table-muslim-population-by-country/>

16 Analytica "Vlerësimi i përpjekjeve të Maqedonisë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, pamja sipas shoqërisë civile" 2016

17 Popullsia myslimane sipas vendit <http://www.pewforum.org/2011/01/27/table-muslim-population-by-country/>

18 BIRN "Xhihadistët Ballkanit, radikalizimi dhe rekrutimi i luftëtarëve në Siri dhe Irak", 2016, qasur në: <http://www.balkaninsight.com/en/file/show/Balkan-Jihadists.pdf>

19 Hulmuesit e QKSS-së janë përpjekur të gjejnë më shumë statistika në lidhje me vendet e tjera të Evropës, por kjo nuk ishte e mundur pasi nuk mund të gjenim burime të besueshme në vende të tjera.

20 Fatos Makolli, Intervistë në Rubikon, 27.09.2016, qasur në: <https://www.youtube.com/watch?v=JvhLcziZHaM>

gratë mbeten kryesisht të izoluar, pa asnjë mbështetje nga institucionet shtetërore apo lokale.<sup>21</sup> Disa prej tyre janë detyruar të martohen sërish pas kthimit në Kosovë. Statistikat tregojnë se numri më i madh i grave nga rajoni i Ballkanit Perëndimor në raport me popullsinë myslimane është nga Bosnja dhe Hercegovina, e ndjekur nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia. Për kokë banori, numri më i madh i grave që janë janë përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut nga rajoni i Ballkanit Perëndimor është nga Kosova, pasuar nga Bosnja dhe Hercegovina.

Në bazë të intervistave dhe raporteve të tjera, analiza tregon se ka shkaqe dhe pasoja të ngjashme mes grave në vendet e Ballkanit që janë përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Gjetjet nga raporti i fundit nga Iniciativa e Atlantikut (2016) vë në dukje se gratë nga Bosnja përfshihen në konfliktin e Sirisë dhe Irakut të nxitura nga faktorë ideologjikë dhe socio - ekonomikë të ngjashëm me ato të Kosovës.<sup>22</sup> Për shembull, shumë prej këtyre grave janë të shtyrë nga burrat e tyre që të përfshihen në konflikt, disa prej tyre kanë emigruar për të gjetur një partner dhe që të martohen në Siri dhe Irak. Për më tepër, ngjashmëritë janë vërejtur sidomos gjatë qëndrimit të tyre në Siri/Irak. Bazuar në raportin e Iniciativës Atlantike dhe intervista me gra kosovare që kanë marrë pjesë në konflikt, gratë boshnjake janë të kufizuara në jetën shtëpiake dhe nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në konfliktin e Sirisë dhe Irakut.

QKSS është përpjekur të gjejë më shumë informacion në lidhje me sjelljen e grave nga Maqedonia, Shqipëria, dhe Serbia gjatë qëndrimit të tyre në Siri, por kjo nuk ishte e mundur për shkak të mungesës së qasjes në informata të besueshme. Intervistat në Kosovë, megjithatë, tregojnë se gratë nga Kosova kanë qëndruar në grup kryesisht me gra të tjera nga Shqipëria për shkak të ngjashmërive gjuhësore. Ngjashmëritë gjuhësore, tregojnë disa nga të gjeturat tona, kanë lejuar edhe që disa luftëtarë nga Kosova dhe Shqipëria të martohen me këto gra gjatë qëndrimit në Siri dhe Irak. I tillë është rasti i Lavdrim Muhaxherit që u martua me një grua nga Shqipëria, burri i mëparshëm i së cilës u vra në luftime.<sup>23</sup>

21 Vëzhgime nga intervistat e QKSS-së

22 Iniciativa Atlantike "Joshja e re e luftës siriane, kontingjenti boshnjak", 2016

23 Intervistë me A. L. 04/10/2016

## 4. FAKTORËT DHE NDIKIMET E JASHTME DHE TË BRENDSHME

Njohja e rrugëve, ndikimeve dhe proceseve të ndryshme që shtynjë një individ për t'u bashkuar me ideologjitë dhe rrejetet ekstremiste është kryesore për zhvillimin e mekanizmave të duhura, jo vetëm për parandalimin e radikalizmit, por edhe për vetë procesin e deradikalizmit. Prandaj, ky seksion analizon faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që shtynjë gratë nga Kosova të përfshihen në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Për të diskutuar këto faktorë, ky raport së pari paraqet tipologjinë e grave të përfshira në ekstremizëm të dhunshëm, pasi gjetjet tona tregojnë se nuk ka “një lloj” të grave që janë përfshirë në konfliktin në Siri dhe Irak. Gjetjet tona tregojnë se në njërin anë ka gra kosovare që janë përfshirë vullnetarisht në konflikt, duke pasur motive dhe qëllime të ndryshme për ta bërë këtë, ndërsa në anën tjetër janë ato që janë detyruar pa vullnetin e tyre të përfshihen në këto konflikte.

Hulumtimet e mëparshme kanë theksuar se gratë në shoqëritë patriarkale gjithnjë e më shumë marrin pjesë në terrorizëm në krahasim me gratë që jetojnë në sistemet sociale më pak patriarkale.<sup>24</sup> Kosova ende aderon më shumë në një formë patriarkale të shoqërisë (në përgjithësi mbizotëron në rajon), pasi pozita aktuale e grave është shumë e pabarabartë përballë burrave.<sup>25</sup> Për më tepër, gratë në përgjithësi portretizohen dhe shihen si viktimat dhe roli i tyre kufizohet në jetën në familje. Kjo pikëpamje shfaqet veçanërisht në shpjegimet e gatshme që jepen në lidhje me rastet e grave që vendosën të përfshihen në konfliktin e Sirisë dhe Irakut.

Hulumtimi ynë, megjithatë, tregon se duhet t'i tejkalojmë këto pohime thjeshtuese në lidhje me “një lloj” të grave dhe pohimet për “shkak të vetëm” rreth pjesëmarrjes së grave në këto konflikte. Së pari, gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se ka gra që u përfshinë vullnetarisht në konflikt, edhe pse të martuara - duke thyer stereotipin se ato janë viktimat të martesës dhe bashkëshortëve të tyre. Për shembull, ‘Arta’<sup>26</sup> ishte në dijeni të ngjarjeve në Siri/Irak, pasi burri i saj kishte udhëtuar atje më parë. Megjithatë, ata vendosën të dy të përfshihen në konfliktin e Sirisë dhe Irakut dhe udhëtuan së bashku herën e dytë. Arta thotë, “vendimi im për të shkuar në Siri/Irak ishte një nga vendimet më të mira që kam marrë ndonjëherë”.<sup>27</sup>

Një rast tjetër i një gruaje që iu bashkua vullnetarisht grupeve të dhunshme ekstremiste si ISIS, ishte rasti i Norës, e cila vendosi të jetë gruaje e tretë e “burrit” të saj. Për më tepër,

24 Raghavan. S. dhe Balasubramanian. V. “Roli në zhvillim i grave në grupet terroriste: progres apo regres?” , Gazeta e Studimeve Ndërkombëtare të Gruas, 2014. 15(2) fq. 207

25 Ibid

26 Emrat e grave që u përfshinë në konfliktin e Sirisë/Irakut janë ndryshuar, pasi të intervistuarat kërkuan që identitetet e tyre të mbeten private.


27 Intervistë me A. L. 04/10/2016

familja e Norës nuk mund ta pranonte martesën me burrin e saj, sepse ata e dinin se ai ishte i martuar dy herë më parë. Nora vendosi se donte të ishte nusja e një “xhihadisti” dhe do të martohej vetëm në të ashtuquajturin “Shtetin Islamik”.<sup>28</sup> Sipas Gazetës Zëri, Nora shpjegon se e di se kush është Lavdrim Muhaxheri dhe atë që ai ka bërë në Siri, por pretendon se ajo cka bëri Muhaxherri nuk është diçka e keqe apo krim, dhe se ai është një njeri i mirë.<sup>29</sup>

Së dyti, ka raste kur gratë vendosën të mos përfshihen në konflikt edhe pse kanë përjetuar presion nga burrat e tyre ose partnerët që kanë marrë pjesë në organizatat ekstremiste.<sup>30</sup> Siç është rasti i “Ritës”, e cila përkundër këmbënguljes së burrit të saj, vendosi të mos udhëtojë në zonën e konfliktit të Sirisë dhe Irakut.

Së treti, raporti konstaton se ka raste të grave që janë detyruar të shkojnë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, si pasojë e drejtpërdrejtë e varësisë nga familjet dhe burrat e tyre.

Për ta kuptuar këtë më mirë, kemi paraqitur grafikisht tipologjinë e grave kosovareve pjesëmarrëse në lufëtra të huaja, në Figurën 1 më poshtë, e cila përfshin faktorët shtytës pas pjesëmarrjes së secilës kategori të gruas në konflikt – faktorë këta që i diskutojmë në seksionet pasuese.



**Figura 1. Tipologjia dhe shtytat e pjesëmarrjes në ekstremizmin e dhunshëm të grave kosovare**

28 “Në ISIS për t’u martuar” 19/11/2015 <http://zeri.info/aktuale/62789/ne-isis-per-t-u-martuar/>

29 “Në ISIS për t’u martuar” 19/11/2015 <http://zeri.info/aktuale/62789/ne-isis-per-t-u-martuar/>

30 Intervistë me S. C. 05/11/2016

Prandaj, jo vetëm që mund të flasim për llojet e ndryshme të grave që marrin pjesë në konflikt (vullnetare dhe të detyruara), por ka edhe motive dhe ndikime të ndryshme që shtyjnë secilin prej këtyre llojeve që t'u bashkohet grupeve të dhunshme ekstremiste. Siç tregon grafiku i mësipërm, ka faktorë shumë kompleksë tërheqës dhe shtytës që nxisin gratë drejt organizatave të dhunshme ekstremiste, siç janë: faktorët ideologjikë, socio - ekonomikë, faktorët personal (të identitetit dhe të izolimit).

Po ashtu, nuk mund të injorojmë faktin se ka disa gra të cilat janë detyruar nga burrat e tyre ose anëtarët e tjerë të familjes së tyre për të shkuar në konfliktin e Sirisë/Irakut. Kjo mund të shpjegohet kryesisht për shkak të varësisë ekonomike nga burrat e tyre, pasi këto gra janë të papuna dhe nuk kanë mbështetje as nga familjet e tyre e as shoqëria në përgjithësi. Për shembull, sipas gazetës Zëri, 'Suzana' ishte e papunë para përfshirjes në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Për më tepër, 'Suzana' kishte mbaruar vetëm shkollën e mesme dhe nuk ndiqte mësimet universitare. Pra, jep shenja të qarta të varësisë ekonomike nga burri i saj.<sup>31</sup>

#### 4.1. Faktorët ideologjikë

Pa dyshim, shumë gra kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e Islamit dhe komunitetit mysliman në rrjedhën e historisë. Pjesëmarrja e gravenë *xhihad* e ka origjinën tek bashkëshortët e Profetit që i shërbenin "në prapaskenë" si burime të këshillimit dhe mbështetjes në luftën e tij të *xhihadit* kundër armiqve të tij nga Meka<sup>32</sup>. Prandaj, ato nuk përfshiheshin në operacionet luftarake. Disa dijetarë të Islamit kanë argumentuar për pjesëmarrjen e grave në një kapacitet të tërthortë apo pasiv - për të siguruar mbështetje për *xhihadistët* dhe për të prodhuar gjeneratën e ardhshme të *xhihadistëve*.<sup>33</sup>

Ka pasur artikuj të shumtë që kanë theksuar dhe diskutuar portretizimin e përgjithshëm të grave në Islam. Kur e diskutojmë këtë çështje me përfaqësueset e Departamentit të Grave në Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), ato pretendojnë se gruaja në Islam gëzon vlerësim dhe respekt të lartë. Sipas përfaqësuesve të Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), gratë kanë të drejtën trashëgimore, një praktikë që nuk është vlerësuar në shoqërinë shqiptare në përgjithësi për shkak të Kanunit.<sup>34</sup> Krahasime të tilla janë bërë në përputhje me qëllimin e theksimit se nuk ka ndarje gjinore në Kuran kur është

31 "Grate nga Kosova ne krye te kampeve te ISIS-it" 26/01/2016 <http://zeri.info/aktuale/73479/grate-nga-kosova-ne-krye-te-kampeve-te-isis-it-foto/>

32 Saikal. A. "Gratë dhe Xhihadi: Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe zhvillimi i qasjeve të raja për zgjidhjen e konflikteve në Lindjen e Mesme", Gazeta e Çështjeve të Pakicave Myslimane, Vol. 36, Nr. 3, 2016. Fq. 316

33 Ibid

34 Kanuni i referohet ligjit tradicional të pashkuar dhe normave sociale të respektuara nga komunitetet shqiptare në zonat malore të Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë.

fjala për zbatimin e parimeve Islame.<sup>35</sup> Sipas kësaj linje ekziston mendimi, që “gratë duhet të jenë të arsimuara dhe të punojnë nëse është e nevojshme”.<sup>36</sup>

Megjithatë, studiues të ndryshëm kanë ngritur pyetje nëse gratë prezantohen në mënyrë të barabartë me burrat në shkrimet e shenjta Islame. Për shembull, historiani David Landes ka deklaruar se shoqëritë myslimane u akordojnë grave një vend më të ulët dhe se kjo është e lidhur në mënyrë të qartë me qëndrimet e kultivuara në Islam.<sup>37</sup> Për shembull, dëshmia e grave në gjykata peshon më pak se ajo e burrave.<sup>38</sup> Pozita e pabarabartë e grave në shkrimet e shenjta Islame paraqitet edhe në Surën 34, Ajeti 4, me titull al - Nisa (gratë), i cili deklaroi se burrat janë superiorë ndaj grave dhe që interpretohet nga disa se i jep burrave të drejtë të aplikojnë dhunë fizike ndaj grave të padisiplinuara.<sup>39</sup>

Kur përfaqësuesit e BIK-ut u pyetën nëse lejohet pjesëmarrja e grave në një konflikt ose në *xihad* në bazë të praktikave Islame, përgjigja ishte një “jo” definitive. Sidoqoftë, opinioni i përgjithshëm është se edhe pse grave nuk u lejohet të marrin pjesë direkt në luftime, historikisht ato u kanë ndihmuar luftëtarëve në konflikt, duke ofruar ndihmë mjekësore dhe kujdes, punët e shtëpisë (gatim, pastrim etj).<sup>40</sup>

Disa nga të intervistuarit deklaruan që kur filloi lufta mes grupeve të ndryshme ekstremiste në Siri dhe Irak, një numër i luftëtarëve të huaj nga Kosova janë vrarë në luftime.<sup>41</sup> Sipas tyre, bashkëshortet e luftëtarëve të huaj nga Kosova, u detyruan me forcë të martohen me xihadistë të tjerë. Arsyeja pse disa nga këto gra u pajtuan të rimartohen me xihadistë të tjerë është se ishin të kërcënuara nga udhëheqësit e grupeve ekstremiste. Disa nga kërcënimet përfshijnë urinë nëse nuk bënin siç u thuhej, dhe në rastet kur sëmureshin ata nuk ua kanë lejuar të vizitojnë mjekun apo të blejnë barna. Kjo duket të jetë strategji e organizatave ekstremiste për t’i detyruar disa nga këto gra të martohen sërish, dyzet ditë pas vdekjes së burrave të tyre.<sup>42</sup>

Sipas intervistave tona me BIK-un, duket se ata janë duke trajtuar gratë që kanë marrë pjesë në konfliktin në Siri dhe Irak si viktime. Një imam në Mitrovicë shpjegon se është mentaliteti nga e kaluara jonë që dikton se “gruaja duhet të jetë aty ku ndodhet burri”. Sipas tij, disa nga gratë janë joshur nga shtëpitë e mëdha dhe propaganda për jetën nën ligjin e ‘Shtetit Islamik’. Një faktor tjetër, i shtuar prej tij, është se “ato janë më të

35 Intervistë me përfaqësues të departamentit të grave të Bashkësisë Islame të Kosovës (30/09/2016)

36 Ibid

37 Masoud. T. dhe Amaney. J. dhe Elizabeth. N. “A përdoret Kuranin për fuqizimin e grave arabe? Teoria dhe Evidenca Eksperimentale nga Egjipti”, Studime Politike Krahasuese, 2016. Vol. 49 (12), fq. 1555-1598

38 Ibid fq. 1561

39 Ibid

40 Intervistë me përfaqësues të departamentit të grave të Bashkësisë Islame të Kosovës (30/09/2016)

41 Intervistë me A.L (04/10/2016) dhe nga intervista me I.L.

42 Intervistë me I. L. në burg 28/06/2016 dhe Intervistë me A. L. 04/10/2016



prirura të jenë të ndjeshme” si gra, për këtë arsye, atyre u është thënë se kur gatujnë ose të kujdesen për xhihadistët do të shpërblehen nga Allahu.<sup>43</sup>

Debatet nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore në Kosovë në lidhje me pjesëmarrjen e grave në konflikt, zakonisht zhvillohen nga perspektiva e grave viktimë - e mungesës së prosperitetit, arsimimit të dobët, ose që detyrohen nga burrat e tyre. Megjithatë, një prej grave kosovare pjesëmarrëse në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, gjatë intervistës argumentoi se nuk e kishte detyruar burri i saj që të përfshihej në konflikt, dhe se ishte thjesht dëshira e saj të shkonte atje. Ajo pohoi se ëndërronte të shkonte dhe të jetonte në Shtetin Islamik.<sup>44</sup> Në mënyrë të ngjashme, nëna e një kosovareje të re që ende ndodhet në Siri dhe Irak, tregoi se pavarësisht përpjekjeve për ta sjellë vajzën e saj përsëri në Kosovë, madje edhe pas vdekjes së burrit të saj në konflikt atje, ajo nuk pranoi dhe zgjodhi jetën në Siri.<sup>45</sup> Këtu kemi të bëjmë me gra të arsimuara, të cilat pavarësisht nga humbja e burrave të tyre kanë vepruar kundër përpjekjeve për t'i rikthyer në Kosovë. Për më tepër, 'Arta', e cila është kthyer, shpjegon se disa nga gratë nga Kosova që ajo ka takuar atje dukeshin të lumtura në Siri para se të fillonte lufta ndërmjet grupeve ekstremiste.<sup>46</sup>

Gratë që lidhen me organizatat e dhunshme ekstremiste si ISIS, jo vetëm që hedhin poshtë kulturën perëndimore, por edhe përqafojnë një botëkuptim të ri. Ato shpresojnë të kontribuojnë në shoqërinë e sunduar nga ISIS sipas interpretimit të rreptë të Ligjit të Sheriatit. Grave që lidhen me organizatën e dhunshme ekstremiste të ISIS-it, u thuhet se kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në këtë shoqëri të re, dhe se ky rol është i bazuar në detyrën e tyre fetare për ta bërë këtë. Shumica e grave që u janë bashkuar organizatave të dhunshme ekstremiste janë të bindura se ishte e detyrueshme për t'u përfshirë në këto konflikte. Në kuadër të këtij procesi të radikalizimit, gratë ashtu si edhe burrat, kanë një besim të fortë në botën tjetër, dhe përmbushja e kësaj detyre të perceptuar fetare shihet si kyç në sigurimin e vendit e tyre në parajsë.<sup>47</sup>

## 4.2. Arsimi dhe punësimi

Teksa nuk mund të supozohet se të gjithë qytetarët që janë përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut ndajnë të njëjtat rrethana socio - ekonomike, është e qartë se një profil i veçantë socio - ekonomik është domimant në mesin e njerëzve të cilët janë lidhur me organizatat e dhunshme ekstremiste. Për shembull, të gjitha gratë që intervistoi QKSS kanë përfunduar shkollën e mesme dhe të paktën një vit studime universitare.

43 Intervistë me Imam Enis Rama, 09.11.2016, Mitrovicë

44 Intervistë me A. L. 4/10/2016

45 Intervistë me K. LL. 02/12/2016 (Nëna e një gruaje tashmë në Siri/Irak)

46 Intervistë me A. L. 15/12/2016

47 Saltman. E. dhe Melanie. S. "Deri sa martirizimi të na ndajë - çështje gjinore dhe fenomeni ISIS" Instituti për Dialog Strategjik, janar 2015, fq. 15

Megjithatë, të gjitha pa përjashtim nuk kanë punuar para se të shkonin në konfliktet në Siri/Irak dhe vazhdojnë të mos punojnë tani që janë kthyer në Kosovë.

Kjo mund të jetë ilustruar me rastin e një prej grave - që ka udhëtuar në Siri/Irak së bashku me burrin e saj për t'iu bashkuar organizatës ekstremiste ISIS - e cila pohoi se kushtet e saj të jetesës dhe sociale u përmirësuan menjëherë në Siri, pasi funksiononte programi i asistencës sociale.<sup>48</sup> Kur ishin në Siri u dhanë shtëpi për të jetuar dhe shijonin, siç tha njëri prej tyre, "një jetë të lumtur".<sup>49</sup> E kthyer në Kosovë, ajo është e papunë dhe mbështet familjen e saj vetëm me asistencë sociale. Ajo jeton në kushte të këqija, së bashku me gjashtë anëtarë të tjerë të familjes së burrit të saj, nga të cilët askush nuk punon. Së bashku me familjen e saj, ata janë të izoluar nga komuniteti i tyre dhe jetojnë në varfëri.

Nëse i ndërlidhim aspektet socio-ekonomike me faktorët e tjerë shtytës e tërheqës, mund të vërejmë se jo detyrimisht ato luajnë një rol të drejtpërdrejtë në nxitjen e grave për t'u përfshirë në organizata të dhunshme ekstremiste. Megjithatë, këta faktorë mund të përdoren si një justifikim i fortë kur këto gra angazhohen në krahasimet mendore të jetës në Kosovë me jetën dhe përkushtim e tyre kur ndodheshin në zonat nën qeverisje nga ISIS apo grupe të tjera të ngjashme.

### 4.3. Familja dhe kushtet e tjera sociale

Në rastin e grupeve ekstremiste, gratë janë të dëmtuara dhe të drejtat e tyre themelore të njeriut janë të kufizuara. Shumë nga grupet ekstremiste bëjnë thirrje që gratë dhe burrat të rikthehen në rolet 'natyrore' dhe 'tradicionale'.<sup>50</sup> Kjo është treguar më dukshëm në rastin e ISIS-it - "Manifesti i grave të brigadës Al-Khansa" kërkon që gratë myslimane ta kenë detyrë braktisjen e "mënyrës perëndimore të jetesës", ku gratë kanë marrë rolin e burrave, dhe u bën thirrje burrave të rikthehen në "natyrën e vërtetë të tyre".<sup>51</sup> Gratë, sipas këtij dokumenti, janë menduar të jenë bashkëshorte dhe nëna të mira të brezit të ardhshëm të luanëve.<sup>52</sup>

### Diskriminimi social

Raporti konstaton se një tjetër faktor që ka ndikuar tek gratë për t'u përfshirë vullnetarisht në konfliktin e Sirisë dhe Irakut është ndjenja e të qenurit e diskriminuar mbi baza

48 Intervistë me A. L. 15/12/2016

49 Intervistë me A.L. 15/12/2016

50 "Gratë që parandalojnë ekstremizmin e dhunshëm - hartimi i një kursi të ri", Instituti Amerikan i Paqes, 2016 fq. 8

51 Winter. Ch. Përkthimi i "Gratë e Shtetit Islamik - Një Manifest për gratë nga Brigada Al - Khansaa", 2015

52 Ibid

fetare, dhe përjashtimi nga institucionet. Për shembull, njëra prej të intervistuarave ka deklaruar se ajo nuk beson se të drejtat e saj si një grua e re myslimane janë duke u respektuar, pasi ankohet se nuk i është lejuar të shkojë në shkollë të mesme publike e veshur me shami.<sup>53</sup>

Teksa vetë përvoja e diskriminimit nuk e bën dikë në një mbështetës të ekstremizmit të dhunshëm, ajo shërben për të nxitur ndjenjat e izolimit brenda një komuniteti më të madh dhe një ndjenjë të distancës nga kultura apo shoqëria. Kjo, në esencë, e bën individin më të ndjeshëm ndaj rrëfimeve ekstremiste, propaganda e të cilëve është e përqendruar kryesisht në krijimin e një ndjenje të përkatësisë.

Statistikat nga Barometri Kosovar i Sigurisë (2016) tregojnë se gratë që janë praktikuese të Islamit tregojnë më shumë besim ndaj institucioneve fetare,<sup>54</sup> me 62% të grave që besojnë më shumë tek institucionet më fetare se burrat me 51%; teksa pak ose shumë pak prej tyre kanë pasur kontakt me BIK-un. Për shembull, 67% e grave thonë se nuk kanë pasur kurrë kontakt me BIK-un, në krahasim me 52% të meshkujve.<sup>55</sup> Në një rën anë, këto statistika tregojnë se BIK-u nuk ka punuar për të përfshirë më shumë gra në strukturat e tyre në radhë të parë, por edhe për të avokuar në emër të të drejtave të grave myslimane.

## 5. REKRUTIMI (GRATË DHE FËMIJËT)

Një aspekt i rëndësishëm i radikalizimit të grave është procesi i rekrutimit në organizata që promovojnë ideologjitë e dhunshme ekstremiste. Rekrutimi në grupe ekstremiste të dhunshme si ISIS është shumë i sofistikuar dhe bëhet përmes një perspektive gjinore. Gratë dhe vajzat rekrutohen në mënyrë të ndryshme në krahasim me rekrutimin e burrave dhe djemve<sup>56</sup>. Ky proces është krijuar enkas për gratë dhe vajzat që janë në një pozitë më të cenueshme se të tjerët. Kjo do të thotë se rekrutuesit e ISIS-it, kryesisht synojnë gratë e reja myslimane në vendet perëndimore përmes platformave të mediave sociale (Facebook, Twitter, Ask.fm, etj.). Gjithashtu, shpesh këto gra të reja joshen me premtime martesë me xhihadistë, premtimin e përkatësisë në një komunitet

53 Intervistë me S.K. 05/11/2016

54 "Pikëpamjet e qytetarëve kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në Kosovë" [http://www.qkss.org/repository/docs/Raporti\\_final\\_CVE-Barometri\\_969038.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Raporti_final_CVE-Barometri_969038.pdf)

55 "Pikëpamjet e qytetarëve kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në Kosovë" [http://www.qkss.org/repository/docs/Raporti\\_final\\_CVE-Barometri\\_969038.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Raporti_final_CVE-Barometri_969038.pdf)

56 Thirrja e Kalifatit: Si u apelon grave Shteti Islamik 28/02/2015 <http://www.economist.com/news/international/21645206-how-islamic-state-appeals-women-caliphate-calling>

dhe familje, u thuhet se po përmbushin detyrën më të lartë si gra të reja myslimane.<sup>57</sup> Megjithatë, ky raport nuk ka konstatime të veçanta në lidhje me rekrutim të posaçëm drejtuar ndaj grave në Kosovë.

Kur analizojmë rastin e Kosovës dhe fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, vërehet një model - shumica e grave që kanë migruar në Siri dhe Irak e kanë bërë të shoqëruara nga bashkëshortët dhe familjet e tyre. Kjo është më e theksuar në rastin e Kosovës sesa në vendet e tjera të Evropës Perëndimore, si Franca, Belgjika etj.<sup>58</sup> Prandaj, është shumë e rëndësishme të analizohet pse familjet së bashku vendosin të përfshihen në konfliktin e Sirisë dhe Irakut dhe çfarë mund të mësojmë nga raste të ndryshme të radikalizimit të familjes.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që lidhet me rekrutimin janë fëmijët kosovarë, të cilët janë viktimë të etërve apo nënave të tyre që marrin pjesë në konfliktin në Siri dhe Irak. Gjetjet tona tregojnë se ka 27 fëmijë nga Kosova aktualisht në Siri dhe Irak. Ka raste të pjesëmarrësve meshkuj të cilët kanë marrë vetëm fëmijët e tyre në Siri dhe Irak, shpesh pa i informuar gratë e tyre - nënat e fëmijëve të tyre. Për shembull, në vitin 2014 ka pasur një rast kur një burrë vendosi të shkojë me konfliktin në Siri dhe Irak dhe mori të birin me vete. Gruaja e tij nuk ishte në dijeni të planeve të burrit të saj. Tre muaj hetime dhe përpjekje nga ana e autoriteteve të ndryshme shtetërore e rikthyen tetë vjeçarin. Në atë kohë, kishte raporte kontradiktore mbi fatin e atit të djalit; disa thoshin se ishte vrarë, ndërsa të tjerë se ishte gjallë. Rasti theksoi disa probleme: e para, kishte mungesë koordinimi ndërmjet Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës me institucionet e tjera të përfshira në këtë çështje. Së dyti, pasi djali u kthye, e gjithë familja e djalit është kërcënuar dhe rasti nuk është trajtuar siç duhet.

Është vërejtur se jo të gjithë burrat pjesëmarrës në konfliktin e Sirisë dhe Irakut kanë emigruar atje së bashku me gratë dhe fëmijët e tyre. Ka pasur disa raste kur gratë nuk kanë pranuar të udhëtojnë me burrat e tyre dhe në vend të kësaj kanë zgjedhur të qëndrojnë në Kosovë. I tillë është rasti i 'Ritës', burri i së cilës, një person i radikalizuar, kishte vendosur të shkonte në konfliktin në Siri dhe Irak dhe u përpoq ta bindur për t'iu bashkuar. Megjithatë, pavarësisht nga ky fakt, ajo e hodhi poshtë me forcë dëshirën e burrit të saj, dhe aktualisht jeton në një fshat në Kosovë, në shtëpinë e prindërve të saj. "Rita" ishte shumë e re kur filloi lidhjen me të; ata ishin së bashku në studimet e tyre universitare. Megjithatë, në vitin e tretë dhe të fundit, burri i saj i filloi të radikalizohet. Ajo pohon se ai filloi të vizitojë shumë shpesh një xhami në Gjilan<sup>59</sup>, gjatë të njëjtës periudhë kur imam Zekirija Qazimi ishte ende aktiv (ai tashmë është i dënuar me 10

57 Ibid & <http://english.aawsat.com/2016/10/article55359989/isis-recruitment-western-arab-women&http://news.sky.com/story/what-became-of-bethnal-green-girls-lured-to-syria-to-join-is-10532801>

58 Saltman Marie & Ross Frennet "Radikalizimi femëror për ISIS-in dhe roli i grave në CVE" fq.142-169 në Fink.N. dhe Sara.Z. dhe Rafia. B. "Bota e burrave, eksplorimi i rolit të grave në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm" 2016 fq.149

59 Intervistë me R.T. 28/09/2016

vjet burg për rekrutimin për terrorizëm dhe gjuhë të urrejtjes)<sup>60</sup>. Gjatë kësaj kohe, ai filloi të shprehë dhimbje për civilët në Siri dhe Irak dhe thoshte se është obligim dhe detyrë e çdo myslimani t'i ndihmojë. Ai la gruan dhe djalin e tij për t'u përfshirë në konfliktin në Siri dhe Irak.

Para se të nisej për Siri dhe Irak, 'Rita' na tha se 'Arbeni' këmbënguli që ajo të mbulohej, pasi nuk mbante shami. 'Rita' kundërshtoi në mënyrë të vendosur. Në muajt e parë pas nisjes së tij në Siri dhe Irak ata kanë mbajtur kontakt dhe 'Arbenin' ku ai e ftoi t'i bashkohej në Siri dhe Irak. Ajo refuzoi, dhe kur e pyetëm pse nuk do të emigrojë atje ajo u përgjigj duke thënë se "e dija se diçka nuk ishte në rregull atje", dhe pastaj vazhdoi të shpjegojë se 'Arbeni' i ka kërkuar edhe një herë të mbulohet pasi të kthehej në Kosovë. Kjo ishte hera e fundit që ajo foli në telefon me të, tre vjet më parë. 'Rita' na tha se ka marrë lajmin se 'Arbeni' është vvarë ose kapur nga forcat e Asadit në qershor 2015.

Ky rast është mjaft interesant, pasi 'Rita' nuk përfaqëson stereotipin e një gruaje viktimë e detyrimit të burrit të saj. Ajo është e papunë dhe refuzon të vazhdojë shkollimin e saj. Pasi mori lajmin e nisjes së 'Arbenit' për Siri/Irak, ajo u shokua dhe ende vazhdon të shfaqë shenja të depresionit. 'Rita' është jashtëzakonisht e zhgënjyer nga veprimet e bashkëshortit të saj dhe mjaft i lodhur nga paragjykimet e fqinjëve të saj dhe personave të tjerë në fshatin ku ajo jeton së bashku me prindërit e saj dhe djalin e saj.

"Djali im është krejt çka kam, dhe dua vetëm t'i siguroj një jetë më të mirë", thotë ajo, pothuajse në lot.<sup>61</sup> Babai i 'Ritës', një burrë 70 vjeçar, nuk mund të durojë vuajtjet e të bijës, edhe pse ajo refuzoi ta ndiqte burrin e saj në Siri dhe Irak ai mendon se po paragjykohet nga komuniteti i saj për faktin e thjeshtë se ka qenë gruaja e një personi që vendosi të luftojë në Siri dhe Irak. 'Rita' së bashku me familjen e saj janë duke u marginalizuar dhe anashkaluar nga fqinjët e tyre dhe njerëz të tjerë në fshat, që nuk duan as të komunikojnë me ata.

## 5.1. Gratë dhe vajzat që kanë migruar me burrat/familjet e tyre

Asnjë nga gratë nga Kosova nuk ka emigruar në Siri dhe Irak vetëm, por të shoqëruara nga bashkëshortët dhe familjet e tyre<sup>62</sup>. Derisa kjo është situata në Kosovë, mund të argumentohet se propaganda e grupeve të dhunshme ekstremiste të tilla si ISIS nuk funksionon me gratë e Kosovës në të njëjtën mënyrë si me gratë nga pjesë të tjera të botës.

60 Dënohet ish-imami Zeqirija Qazimi 20/05/2016 <http://kallxo.com/denohet-zeqirja-qazimi/>

61 Intervistë me R.T. 28.09.2016

62 Fatos Makolli, Intervistë në Rubikon 27/09/2016, qasur në: <https://www.youtube.com/watch?v=JvhLcriZHaM>

Së pari, ka video të shumta në internet që shënjestrojnë gratë, por janë kryesisht në gjuhën angleze, duke synuar gratë që jetojnë në vendet perëndimore, kryesisht Britani e Madhe.<sup>63</sup> Në rastin e Kosovës, studiuesit e QKSS-së nuk mundën të gjejnë video propagandistike që synojnë në mënyrë specifike gratë nga Kosova apo zona të tjera shqipfolëse nëpërmjet propagandës së përshtatur në shqip. Kjo është në kundërshtim me disa video propagandistike me burra që u drejtohen burrave të tjerë në gjuhën shqipe.<sup>64</sup>

Është natyrshëm e vështirë të përshkruhen me një profil të vetëm gratë që janë duke emigruar për në Siri dhe Irak. Secila ka rrethana dhe histori të ndryshme, dhe ka faktorë të ndryshëm shtytës e tërheqës që i shtojnë këto gra dhe vajza të migrojnë në Siri dhe Irak. Megjithatë, mund të vërehen disa karakteristika të përgjithshme në mesin e grave pjesëmarrësve në konfliktin e Sirisë dhe Irakut: (i) mosha e re; (ii) mungesa e informacionit në lidhje me konfliktin në Siri dhe Irak; (iii) martesë në moshë të re (rreth të njëzetave); (iv) ka filluar praktikimin e fesë kohët e fundit, para se të përfshihej në konflikt (procesi ishte i shpejtë); (v) ka përjetuar një ngjarje traumatike (humbja e një personi të dashur ose një ngjarje tjetër personale) më parë në jetën e tyre.

'Arta' është një nga gratë që ka shkuar në konfliktet e huaja në Siri dhe Irak. Ajo është 26 vjeç, i ati i saj vdiq kur ajo ishte vetëm 8 vjeç, ndërsa nënën e humbi kur ishte 18 vjeç. Pas vdekjes së prindërve të saj, vëllezërit kujdeseshin për të. Teksa jetonte me vëllezërit, ajo nuk kishte asnjë vështirësi financiare. Ajo ishte regjistruar në universitet, dhe familja e shtynte të përfundonte studimet; por ajo e la universitetin në vitin e tretë. Ajo flet rrjedhshëm anglisht.

Familja e saj nuk e pëlqente I. L. për kunat, sepse ata nuk e shihnin si të përshtatshëm për motrën e tyre. Kur u pyet nëse burri i saj (i cili ka qenë pjesëmarrës në konfliktin në Siri dhe Irak) e ka shtyrë atë në ndonjë mënyrë për të emigruar së bashku në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, ajo tha se nuk e kishte detyruar të shkonte në Siri dhe se ajo vendosi vetë që t'iu bashkonte dhe të migronin së bashku. Ajo vazhdon të thotë se Islami e obligon për këtë, dhe "nëse praktikon Islamin ndihesh mirë kur ju ndihmon njerëzve dhe kjo është detyrë fetare".<sup>65</sup> Familja e saj nuk kishte njohuri për vendimin e saj për të emigruar në Siri dhe Irak, madje i mashtruan duke u thënë se bashkë me burrin do të emigronin në Francë në kërkim të një jete më të mirë.

Për më tepër, procesi i rekrutimit në këtë rast është bërë me anë të burrit të saj dhe jo direkt nga propaganda e ISIS. Në kohën e intervistës, ajo nuk ishte përdorur për vendimin e saj për t'u përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Ajo theksoi faktin se

63 "Gratë e huaja në Siri! Përballen me të vërtetën" qasur në: <https://www.youtube.com/watch?v=jQUJGB6zJKs&>"Nje femër nga Britania në luftë në Siri" Qasur në: <https://www.youtube.com/watch?v=NUQeOq16n-Q>

64 "Thirja për xhihad", qasur në [https://www.youtube.com/results?search\\_query=thirja%20per%20xhihad%20%20shqip%20](https://www.youtube.com/results?search_query=thirja%20per%20xhihad%20%20shqip%20)

65 Intervistë me A. L. 15/12/2016

nëse konflikti nuk do të kishte filluar, ajo do të preferonte të vazhdojnë të jetonte në Siri. Gjatë intervistës, ajo derdhi lot për shoqen e saj somaleze, të cilin e konsideron si motër. 'Arta' thekson se nuk ka kontakt me të dhe nuk ka asnjë informacion nëse shoqja e saj është ende gjallë apo ka vdekur.<sup>66</sup>

Megjithatë, kur hulumtuesit e QKSS-së e pyetën nëse ajo ende mbështet ISIS-in, përgjigja e saj ishte: "definitivisht po". Njerëzit të cilët potencialisht janë të radikalizuar nuk besojnë në sistemin aktual në Kosovë ose diku tjetër në Perëndim dhe dëshirojnë të jetojnë nën ligjin e Shtetit Islamik. Ky rast paraqet faktin se institucionet shtetërore në Kosovë duhet të përqendrohen në procesin e de-radikalizimit dhe se këto programe duhet të jenë të përshtatura për çdo rast. Hulumtuesit e QKSS-së vërejnë se 'Arta' vazhdon të jetë e radikalizuar, edhe pse fakti që ajo u pajtua të takohet disa herë dhe të komunikojë me hulumtuesit nga QKSS është një shenjë e parë e mirë për mundësinë që disa prej këtyre rasteve të angazhohen në mënyrë kuptimplote me pjesën tjetër të shoqërisë, çka mund të çojë në ri-integrimin e saj dhe pranimin e normave sociale jashtë kontekstit ISIS-it.

'Arta' është një rast shumë i veçantë, pasi konfirmon pikëpamjen se gratë nuk janë vetëm viktime, por shumë shpesh iu bashkohen më dëshirë grupeve ekstreme të dhunshme. Për shembull, 'Arta' mund të konsiderohet një person i mirë-arsimuar që nuk vjen nga një sfond i varfër socio-ekonomik. Faktori më i fuqishëm që ka kontribuar radikalizimin e saj duket së është martesja e saj ose bashkimi me partnerin e saj, i cili ishte person i radikalizuar dhe besonte në ideologji ekstremiste.

Rekrutimi është një nga aspektet më të rëndësishme të radikalizimit, veçanërisht për gratë. Organizatat e dhunshme ekstreme kanë treguar se kanë mekanizma shumë efikas rekrutimi që synojnë sidomos gratë perëndimore, pasi atyre u përkujtohet vazhdimisht se në territorin e të ashtuquajturit Shtetit Islamik nuk do të konsiderohen si "objekte seksuale", por do të vlerësohen si nëna që janë të afta të rrisin brezin e ardhshëm të myslimanëve. Kjo nuk mbizotëron në rastin e grave kosovare, pasi rekrutuesit e mundshëm janë ndoshta të vetëdijshëm për mentalitetin e ndryshëm në lidhje me gratë në kontekstin e Kosovës, në krahasim me atë në Perëndim. Në vend se të krijojnë materiale të veçanta rekrutimi - me propagandë në internet, burrat tashmë të radikalizuar që kanë një lloj marrëdhënieje me gratë kthehen në "rekrutuesit" kryesorë, ose në këtë rast udhëzuesit e udhëtimit të këtyre grave në Siri dhe Irak.

## 5.2. Jeta në Siri dhe Irak për gratë kosovare

Gratë nga Kosova që jetojnë në territorin e mbajtur nga ISIS u përmbahen roleve dhe normave tradicionale gjinore. Ato nuk shihen jashtë shtëpive të tyre dhe detyrat e tyre janë të kufizuara në jetën shtëpiake (kryesisht gatim, pastrim dhe përkujdesje

66 Ibid

për fëmijët e tyre)<sup>67</sup>. Gratë kosovare kryesisht qëndrojnë bashkë, për shkak të faktit se flasin të njëjtën gjuhë. Gratë e martuara qëndronin me burrat e tyre dhe të ndarë nga beqaret që jetonin në shtëpitë e tjera, të quajtura *maqqar*<sup>68</sup>, deri kur të marrin oferta martesë<sup>69</sup>. Kjo është përshkruar në disa tregime të ndryshme dhe shumë gra e theksuan këtë gjë. Edhe pse këto gra bëjnë jetë kryesisht shtëpiake, rolet e tyre të brendshme mbulohen me lavdi; ato nuk i shohin rolet e tyre si të kufizuara, por më tepër si të drejta shpirtërisht.<sup>70</sup>

Megjithatë, të intervistuarat u treguan të kujdesshme të theksojnë se këto shtëpi nuk përfaqësojnë në asnjë mënyrë kampe ushtarake apo diçka të ngjashme, pasi siç u theksua më lart, gratë nën ISIS nuk mund të mbajnë pozita luftarake ose të marrin pjesë të drejtpërdrejta në *'xhihad'*. Grave emigrante nuk u është lejuar të mbajnë armë si pjesëmarrëse në luftë në asnjë formë apo mënyrë.<sup>71</sup> Ndërkohë që mund qarkullojnë në internet disa video të grave që mbajnë armë dhe madje edhe i zbrazin në disa raste, të intervistuarat tona thanë se gratë atje [në Siri / Irak] kishin armë që përdoren për mbrojtje.<sup>72</sup> Gratë në këto zona konflikti shihen thjesht si nënat dhe gratë e xhihadistëve, ato që "do të rrisin gjeneratën e ardhshme të muxhahidëve"<sup>73 74</sup>. Për më tepër, informatorët konfirmuan se "atyre [grave] nuk u lejohej as t'i vizitonin kampet ku luftëtarët e huaj stëviteshin për të luftuar".<sup>75</sup>

Disa raporte në media lokale, duke cituar burime nga "sektori i sigurisë"<sup>76</sup> në Kosovë, kanë folur në lidhje me ekzistencën e "kampeve" që janë të udhëhequra nga disa gra kosovare luftëtare të huaja. Pavarësisht nga një hulumtim në thellësi për të gjetur ekzistencën e kampeve të tilla nëpërmjet intervistave tona me gra të ndryshme të përfshira direkt në konflikt dhe me sektorin e sigurisë, ne nuk mund të verifikojmë ekzistencën apo pozitën udhëheqëse të grave nga Kosova në "kampe" të tilla. Besojmë se termi "kampet" mbetet i paqartë, pasi nuk dihet nëse ka të bëjë me komplekset e banimit të përmendura më lart, apo me kampe konvencionale ushtarake. Bazuar në intervistat e kryera me gratë emigrante në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, por edhe duke konsultuar literaturën (duke përfshirë botimet e ISIS-it, drejtuar grave dhe për gratë), është e qartë se gratë në Siri dhe Irak nuk kanë të drejtë të mbajnë pozicione udhëheqëse. Përveç pretendimit për vendosjen e sundimit të ligjit të Sheriatit, ISIS ka

67 Marrë nga intervistat me A. L. (04/10/2016) dhe N. P. (08/10/2016)

68 Saltman dhe Ross 2016, fq.151

69 Ibid.

70 Fink. N. dhe Sara.Z. dhe Rafia. B. "Bota e burrave", 2016

71 Ibid dhe "Derisa martirizimi të na ndajë", Instituti për Dialog Strategjik, 2015. fq. 14

72 Marrë nga intervista me A. L. (04/10/2016)

73 "Fitrah e njerëzimit - dhe shuarja e afërt e gruas perëndimore", Revista Dabig, edicioni 2015, fq. 23

74 Winter. Ch. Përkthimi i "Gratë e Shtetit Islamik - Një manifest mbi gratë nga Brigada Al - Khansaa", 2015, fq.17-18

75 Marrë nga intervista me A. L. (04/10/2016)

76 "Gratë nga Kosova në krye të kampeve të ISIS-it" 26/01/2016 <http://zeri.info/aktuale/73479/grate-nga-kosova-ne-krye-te-kampeve-te-isis-it-foto/>



shkuar një hap më tej dhe ka konsoliduar një lloj të policisë së grave të quajtur Brigada Al - Khanssaa.<sup>77</sup> Roli i tyre kryesor është të sigurohen se gratë vishen siç duhet dhe veprojnë sipas ligjit të shpallur nga ISIS. Publikimi i të ashtuquajturit “Gratë e Shtetit Islamik: Manifesti dhe Rasti Studimor”, jep udhëzime të qarta dhe përshkruan rolin e grave në territorin e mbajtur nga ISIS. Përkthimi në anglisht referohet se “gratë duhet të qëndrojnë prapa dyerve të mbyllura dhe të dalin nga shtëpia vetëm në rrethana të jashtëzakonshme”.<sup>78</sup> Më pas, argumenton se “funksioni themelor” i një gruaje është që të jetë në shtëpinë e saj me burrin dhe fëmijët e saj, duke shtuar se gratë mund të lejohen të largohen nga shtëpia në rrethana shumë të jashtëzakonshme - për të bërë *xhihad* vetëm dhe vetëm atëherë kur nuk ka burra në dispozicion, për të studiuar fenë, dhe se mjekeve dhe arsimtareve u lejohet të largohen nga mjediset e tyre vetëm në zbatim të repte të udhëzimeve të ISIS-it të interpretuara sipas Sheriatit.<sup>79</sup>

Roli dhe përgjegjësia e grave shtjellohen më tej në revistën online që ISIS publikon çdo muaj. Revista Dabiq, që publikohet në internet dhe shënjestron kryesisht “Perëndimin”, promovon vlera të ngjashme. Në edicionin e tyre të fundit botuan një artikull që shënjestronte në mënyrë specifike gratë, ku përshkruhej mënyra “e duhur” e jetës.

Sipas dëshmimeve aktuale, është shumë e dyshimtë nëse gratë në përgjithësi, dhe sidomos ato nga Kosova, janë duke udhëhequr këto të ashtuquajtura “kampe”. Edhe sikur disa gra të merrnin pjesë në brigadën Al-Khanssaa, kjo nuk është pjesë e krahut të armatosur të ISIS-it, që lufton në beteja, pra nuk marrin pjesë në operacionet e drejtpërdrejta luftarake. Grave që marrin pjesë në brigadë u lejohet vetëm të sigurohen se ligji është duke u duhet respektuar. Kjo ndryshon kur ISIS krahasohet me grupe të tjera ekstremiste si Boko Haram për shembull, apo edhe Al-Qaeda/Al-Nusra, ku dihet se gratë kanë marrë pjesë në akte terroriste, të tilla si shpërthimet vetëvrasëse. Ky raport nuk mund ta përjashtojë mundësinë që grate e Kosovës pjesëmarrëse në organizata ekstremiste, marrin pjesë në disa akte të dhunshme, edhe pse me provat në dispozicion deri më tani, ky raport e hedh poshtë një hipotezë të tillë.

77 “Xhihadistet publikojnë udhëzues për jetën nën Shtetin Islamik” 05/02/2015

<https://www.theguardian.com/world/2015/feb/05/jihadist-girl-marry-liberation-failed-islamic-state>

78 Winter.Ch. Përkthimi i “Gratë e Shtetit Islamik - Një Manifest për gratë nga Brigada Al - Khanssaa”, 2015

79 Winter.Ch. Përkthimi i “Gratë e Shtetit Islamik - Një Manifest për gratë nga Brigada Al - Khanssaa”, 2015

## 6. GRATË SI PARANDALUESE TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Gratë janë anashkaluar shumë gjatë në diskutimin e përpjekjeve parandaluese dhe të de-radikalizimit. Studimet e fundit sugjerojnë se gratë kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur, veçanërisht në parandalimin në përgjithësi,<sup>80</sup> përfshirë edhe në Kosovë. 'Women without Borders', një organizatë me bazë në Austri, ka kryer një studim në vitin 2013 në Pakistan, Izrael, Palestinë, Irlandë të Veriut dhe Nigeri për të testuar hipotezën se nënat janë shpesh më shumë të lidhura me familjet dhe komunitetet e tyre dhe për këtë arsye është thelbësore që të pranohet se ato kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në përpjekjet për parandalim. Studimi konfirmoi hipotezën, pasi gjeti se nënat kanë një prani të vazhdueshme në jetën e fëmijëve të tyre, me lidhje të rrënjosura thellë dhe i kuptojnë faktorët shtytës dhe tërheqës: nga çka i ngazëllen, i shqetëson, dhe çfarë mund t'i joshë në një komunitet dhune.<sup>81</sup> I njëjti studim gjetur se nënat në mënyrë specifike kanë frikë disa karakteristika individuale dhe sociale si faktorë të rrezikut: 1. Dëshirën për hakmarrje, 2. Paqëndrueshmërinë e bashkësisë, 3. Cenueshmërinë nga presioni i grupit, 4. Traumata dhe/ose humbjet dhe 5. Vetë-izolim;<sup>82</sup> faktorë që jo rrallë mund të vërehen tek njerëzit që janë në fazën e radikalizimit ose besojnë në ideologji të dhunshme ekstremiste.

Kur diskutojmë gratë si parandaluese të ekstremizmit të dhunshëm, një rast tjetër i angazhimit të suksesshëm të grave në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, është ai i nënave që krijuan 'Mothers for Life', një rrjet i grave që kanë humbur fëmijët e tyre në betejat e xhihadit.<sup>83</sup> Këto gra apo nëna janë shumë aktive për të rritur vetëdijen dhe mbështetjen e prindërve. Është hera e dytë që në Ditën e Nënës, këto gra - e vetmja shoqatë ndërkombëtare në botë e nënave që kanë humbur fëmijët e tyre të ashtuquajtur "luftëtarë të huaj", 'Mothers for Life' - kanë publikuar një letër të hapur drejtuar liderit Abu Bakr al-Baghdadi të të ashtuquajturit 'Shtetit Islamik'.

Letra ndan ndjenjat e tyre për fëmijët e humbur, rolet e tyre në lidhje me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, dhe këto gra nxisin të gjithë prindërit nga e gjithë bota të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje dhe të flasin të vërtetën.

80 "Munden nënat ta sfidojnë ekstremizmin? Perceptimet dhe qëndrimet e nënave mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm", Gratë pa Kufi, 2015

81 Ibid

82 Ibid fq. 4

83 "Askush nuk më ndihmoi ta ndaj djalin nga ISIS" 02/05/2016 <https://www.theguardian.com/world/2016/may/02/joining-isis-foreign-jihadis-syria-deradicalisation>

Gati një vit më parë folëm për ndjenjat tona në lidhje me ju - bijtë dhe bijat tona - që jeni vrrarë në Siri dhe Irak, ose që ju bëjnë thirrje të bashkoheni në një luftë që nuk është e juaja. Në vend që të marrim përgjigje për pyetjet tona, na kanë qortuar, përqeshur dhe sulmuar ata që pretendojnë se mbështesin vlerat dhe traditat e Islamit dhe ata që e urrejnë Islamin. Ata bëhen aleatë duke na sulmuar. Përfaqësuesit e të ashtuquajturit “Shteti Islamik” na quajtën qesharake dhe nuk e pranuan dhimbjen që në ndiejmë për humbjen tuaj.<sup>84</sup>

Roli i prindërve, dhe nënës veçanërisht u theksua edhe nga një prej bashkëbiseduesve tonë. Albert Berisha, një ish luftëtar i huaj i kthyer nga Siria dhe Iraku në Kosovë na tregoi përvojën e tij. Alberti shpjegon si nëna e tij kishte luajtur rolin më të rëndësishëm në vendimin e tij për t’u kthyer në Kosovë:

Isha në Siri, po festonim Bajramin dhe mora një telefonatë nga nëna ime. Më uroi Bajramin dhe ai ishte momenti që vendosa të kthehem në Kosovë, nga malli për nënën. Zëri i saj ma kujtoi dashurinë që nëna ime ka për mua dhe sakrificat që ajo kishte duruar sa na rriti mua dhe vëllezërit. E dija se tepër trishtohej nga vendimi im dhe se duhej të bëja gjithçka të mundur që të kthehesha në Kosovë, për hir të saj.<sup>85</sup>

Në rastin e Kosovës, gratë ose nënat e luftëtarëve të huaj janë të marginalizuara nga shoqëria. Kur QKSS u takua me disa prej tyre, ato refuzuan të flasim për fëmijët e tyre. Krahasuar me vende të tjera, si Britania e Madhe apo Gjermania, Kosova ende nuk sheh ndonjë rol që mund ta luajnë nënat në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Institucionet e Kosovës duhet të fuqizojnë këto gra, duhet t’u japin mbështetje, sepse këto gra mund të ndajnë përvojat e tyre në lidhje me fëmijët e tyre dhe mund të jenë shumë të dobishme në lidhje me prindërit dhe gratë të reja të tjera që mund të radikalizohen.

84 Nënës për jetën: <http://girds.org/mothersforlife>

85 Intervistë me Albert Berisha 12/01/2017

---

## 7. KONKLUZIONE

---

Ky raport arrin në përfundimin se:

1. Nuk ka “një lloj” të grave kosovare që janë përfshira në konfliktin e Sirisë dhe Irakut. Disa prej tyre janë bashkuar vullnetarisht - të shtyra nga motive të ndryshme, ndërsa të tjera janë detyruar ta bëjnë këtë. Për më tepër, raporti konstaton se fuqizimi i grave të reja, dhe sidomos nënave, në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe publike është shumë i rëndësishëm për të pakësuar radikalizimin e grave që çon në ekstremizëm të dhunshëm.
2. Portretizimi i grave vetëm si viktime të organizatave ekstremiste të dhunshme është i pasaktë dhe pengues, pasi raporti konstaton se ka gra që jo vetëm janë bashkuar vullnetarisht me organizata ekstremiste të dhunshme, por edhe kanë ndihmuar në procesin e rekrutimit, apo bindjes, së grave të tjera.
3. Edhe pse këto gra mund t’u jenë bashkuar organizatave të dhunshme ekstremiste me qëllim të mbështetjes së të ashtuquajturit ‘xhihad’, roli i tyre është mjaft i kufizuar, pasi ISIS për shembull nuk u lejon grave të marrin pjesë në luftime, dhe ofron shumë pak hapësirë publike për gratë. Aktiviteti i grave është i kufizuar në jetën shtëpiake dhe vlerësohen vetëm si nëna që do të rrisin gjeneratën e ardhshme të “luanëve”.
4. Edhe pse arsimi dhe faktorë të tjerë socio - ekonomikë luajnë një rol në procesin e radikalizimit, këta faktorë nuk janë shkaku kryesor i ekstremizmit të dhunshëm. Ajo që duket të jetë më e rëndësishme [se niveli i arsimimit dhe faktorët socio - ekonomikë] janë tiparet individuale, të tilla si nevoja për të provuar veten dhe përvojat e kaluara traumatike (humbja e një personi të dashur apo ngjarje të tjera).
5. Baza e radikalizimit është jokonformizmi. Njerëzit të cilët janë radikalizuar dhe u janë bashkuar grupeve të dhunshme ekstremiste nuk janë të kënaqur me sistemin aktual (shoqëror apo politik) dhe dëshirojnë ta ndryshojnë. Ata zgjedhin t’i kanalizojnë ndjenjat e tyre jokonformiste duke u bashkuar me grupet e dhunshme ekstremiste.
6. Gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave për këtë raport, është vërejtur se gratë janë të përjashtuara dhe nuk përfaqësohen nga asnjë organizatë që merret me barazinë gjinore. Gratë nuk përfaqësohen nga organizatat e shoqërisë civile dhe nga BIK-u. Megjithatë, nuk ndodh kështu në të gjitha komunat e Kosovës, pasi kjo është më e theksuar në komunat më të vogla.

## 8. REKOMANDIME

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, QKSS ka rekomandimet e mëposhtme:

### ***Për Qeverinë e Kosovës:***

1. Në diskursin global, roli i grave në procesin e parandalimit dhe të de-radikalizimit ka një vend të rëndësishëm. Kjo vihet re sidomos në shoqëritë ku nënat kanë një rol të rëndësishëm në jetën e fëmijëve. Qeveria e Kosovës duhet të fuqizojë rolin e grave në përgjithësi dhe nënave në mënyrë specifike për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm. Kjo mund të arrihet me aktivitete të ndryshme në nivel lokal që të angazhohen këto gra në të gjitha nivelet e proceseve të vendim-marrjes.
2. Gratë nga Kosova, të cilët janë kthyer nga konflikti i Sirisë dhe Irakut, janë të izoluar dhe nuk marrin pjesë në proceset e rehabilitimit dhe riintegrit. Prandaj, QKSS rekomandon që këto gra duhet të përfshihen në këto programe që janë të pjesë e Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm 2015 - 2020.<sup>86</sup>
3. Këto programe duhet të përshtaten për secilin rast të grave të kthyer nga konflikti i Sirisë dhe Irakut dhe duhet të përqendrohen në nevojat personale të çdo gruaje të kthyer në Kosovë nga konfliktet në Siri dhe Irak. Kjo ka qenë e suksesshme në vende të tjera që kanë zbatuar programe të tilla të de-radikalizimit.
4. Familjet duhet të përfshihen në programet e de-radikalizimit, sepse ato janë të paragjykuara nga komuniteti dhe të përjashtuara nga institucionet.

### ***Për BIK-un:***

1. BIK-u duhet të ofrojë më shumë hapësirë për gratë që duan të jenë aktive në kuadër të këtij institucioni, si dhe t'i fuqizojë bazuar në praktikën e saj tradicionale dhe në Kushtetutë.
2. BIK-u duhet të jetë më proaktiv në luftën kundër diskriminimit kundër grave myslimane praktikuese fetare në Kosovë.

<sup>86</sup> "STRATEGJIA PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMIT QË SHPIE NË TERRORIZËM 2015 - 2020"[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA\\_parandalim\\_-\\_SHQIP.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf)

3. Departamenti i grave të BIK-ut duhet të mbështetet më shumë nga përfaqësuesit e bashkësisë Islame.
4. Vetëm kur gratë myslimane të fuqizohen në kuadër të BIK-ut dhe bashkësisë Islame në përgjithësi dhe në çdo komunë, gratë do të jenë në gjendje të kontribuojnë në masat e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Kjo duhet të zbatohet, sepse gratë do t'i marrin informacionet dhe ligjëratat direkt nga BIK-u dhe nuk do të varen nga burrat e tyre ose anëtarët e tjerë të familjeve të tyre për mësimet mbi Islamin.

### ***Për Organizatat e Shoqërisë Civile:***

1. Puna e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) nuk duhet të fokusohet vetëm në Prishtinë, por duhet të zgjerohet në zonat rurale të Kosovës.
2. OSHC-të që punojnë me barazinë gjinore duhet të përqendrohen në krijimin e programeve që fuqizojnë rolin e nënave, sidomos në zonat rurale, pasi me anë të hulumtimit tonë është vërejtur se nënat luajnë një rol shumë të rëndësishëm në parandalim dhe de-radikalizim. Roli i tyre është veçanërisht i rëndësishëm në njohjen e shenjave të para të radikalizimit, të tilla si: izolimi, ndryshimi i sjelljes, trauma, mënyra si e kalojnë fëmijët kohën e tyre të lirë, etj.
3. Këto organizata duhet të fokusohen në fuqizimin e rolit të grave në zonat rurale, ku banon shumica e popullsisë së Kosovës. Këto organizata duhet të shërbejnë si një platformë ku gratë ndihen të sigurt për të shprehur mendimet e tyre, jo vetëm rreth ekstremizmit të dhunshëm, por edhe në lidhje me shqetësimet e tjera që ato mund të kenë.
4. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) në Kosovë duhet të kenë më shumë bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës (BIK), veçanërisht në nivel lokal dhe me departamentin e grave brenda BIK-ut.
5. OSHC-të duhet të nxisin programe të de-radikalizimit që ofrojnë kushtet e nevojshme për gratë që kanë qenë të përfshira në konfliktet në Siri dhe Irak për të diskutuar lirshëm në lidhje me përvojën e tyre. Për më tepër, OSHC-të nuk duhet të jenë paragjyquese ndaj grave që kanë qenë në konfliktet e Sirisë dhe Irakut.

---

## BIBLIOGRAFIA

---

A. L. Intervistë 20/10/2016, Prishtinë, Kosovë

Një letër e dytë për Abu Bakr al-Baghdadi nga Nëna për jetën. Nënata për jetën: <http://girds.org/mothersforlife>

Analytica "Vlerësimi i përpjekjeve të Maqedonisë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, pamja sipas shoqërisë civile" 2016

Anderson. S. "Gratë Mbijetojnë. Ato nuk jetojnë". Foreign Policy, 2016, qasur në: <http://foreignpolicy.com/2016/10/11/women-survive-they-do-not-live-isis-islam-yazidi/>

Azinovic. M. dhe Muhamet. J. "The new lure of the Syrian War – The Foreign Fighters' Bosnian contingent" Atlantic Initiative, Prill 2016

Burke, J. "Islamic militant groups' recruits likely to be well educated, study finds" qasur në: [https://www.theguardian.com/world/2016/oct/05/islamic-state-recruits-world-bank-study-education-boko-haram?CMP=Share\\_iOSApp\\_Other](https://www.theguardian.com/world/2016/oct/05/islamic-state-recruits-world-bank-study-education-boko-haram?CMP=Share_iOSApp_Other)

Munden nënata ta sfidojnë ekstremizmin? perceptimet dhe qëndrimet e nënave mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Gratë pa Kufi, 2015

**Caliphate calling** - *How Islamic State appeals to women*. Feb 26<sup>th</sup> 2015 <http://www.economist.com/news/international/21645206-how-islamic-state-appeals-women-caliphate-calling>

Denohet Zekerija Qazimi me 10 Vite burg per terrorizem. Klan Kosova, Maj 2016, Qasur në: <http://klankosova.tv/denohet-zekerija-qazimi-me-10-vjet-burg-per-terrorizem/>

Fatos Makolli Intervistë në Rubikon, 27.09.2016. Qasur në: <https://www.youtube.com/watch?v=JvhLcriZHaM>

Fin Church Aid "New evidence: Neighbours, not Firebrand Imams, recruit Fighters to Boko Haram" 3/10/2016 Accessed at: <https://www.kirkonulkomaanapu.fi/en/latest-news/news/new-evidence-friends-not-firebrand-imams-recruit-fighters-to-boko-haram/>

Gazeta Tema "Regjistrimi I popullësisë, 96% te kosovareve jane myslimane" Qasur në: <http://www.gazetatema.net/web/2012/02/09/regjistrimi-i-popullësisë-96-e-kosovareve-jane-myslimane/>

Gazeta Zeri "Grate nga Kosova ne krye te kampeve te ISIS-it" 26/01/2016 Qasur në: <http://zeri.info/aktuale/73479/grate-nga-kosova-ne-krye-te-kampeve-te-isis-it-foto/>

Gazeta Zeri "Në ISIS për t'u martuar" 19/11/2015 Qasur ne: <http://zeri.info/aktuale/62789/ne-isis-per-t-u-martuar/>

Halliday, J. "Female jihadist publish guide to life under Islamic State", The Guardian, 2015 Qasur në: <https://www.theguardian.com/world/2015/feb/05/jihadist-girl-marry-liberation-failed-islamic-state>

Huckerby, J. "Why Women Join Isis". Time Magazine, 2015 Accessed on 24/10/2016 <http://time.com/4138377/women-in-isis/>

Intervistë me përfaqësues të departamentit të grave të Bashkësisë Islame të Kosovës (30/09/2016)

Intervistë me Albert Berisha 12/01/2017. Prishtinë, Kosovë

Intervistë me K. LL 02/12/2016

Intervistë me S. K. 05/11/2016

Intervistë me R. T. 28.09.2016

Intervistë me Imam Enis Rama, 09.11.2016, Mitrovicë

Masoud. T. dhe Amaney. J. dhe Elizabeth. N. "A përdoret Kuranin për fuqizimin e grave arabe? Teoria dhe Evidenca Eksperimentale nga Egjipti", Studime Politike Krahasuese, 2016. Vol. 49 (12), fq. 1555-1598

Mietz, E. "What about the women? Understanding and Addressing the problem of ISIS Female Recruitment in the Western Balkans" Belgrade Center for Security Policy, 2016, pg.6

Muslim Population by Country, Qasur në: <http://www.pewforum.org/2011/01/27/table-muslim-population-by-country/>

N.P. Intervistë 08/10/2016, Prishtinë, Kosovë

Nidaa Abou Ali, ISIS Recruitment between Western, Arab Women, October 11, 2016 <http://english.aawsat.com/2016/10/article55359989/isis-recruitment-western-arab-women>



Raghavan. S. dhe Balasubramaniyan. V. "Roli në zhvillim i grave në grupet terroriste: progres apo regres?" , Gazeta e Studimeve Ndërkombëtare të Gruas, 2014. 15(2) fq. 197-211

Saikal. A. "Gratë dhe Xhahadi: Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe zhvillimi i qasjeve të raja për zgjidhjen e konflikteve në Lindjen e Mesme", Gazeta e Çështjeve të Pakicave Myslimane, Vol. 36, Nr. 3, 2016. Fq. 316

Saltman.E. dhe Melanie. S. "Deri sa martirizimi të na ndajë - çështjet gjinore dhe fenomeni ISIS", Instituti për Dialog Strategjik, 2015, f. 4

Saltman.E. dhe Ross.F. "Female Radicalization to ISIS and the Role of Women in CVE" in "A Man's World? Exploring the Roles of Women in Countering Terrorism and Violent Extremism", The Global Center on Cooperative Security, 2016 pg.146

Selimi. K. & Filip. S. "Assessment of Macedonia Efforts in Countering Violent Extremism, View From Civil Society" Analytica, 2016. [http://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web\\_ceb98.pdf](http://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf) pg.10

Spahiu. E. "Foreign Fighters, Religious Radicalism and Violent Extremism in Albania and the Western Balkans" fq.57 - 87 2015, qasur në:[http://www.filipejdus.com/Public/Uploads/Attach/jurekovic\\_and\\_ejdus\\_2016\\_violent\\_extremism\\_579f5bba2729b.pdf](http://www.filipejdus.com/Public/Uploads/Attach/jurekovic_and_ejdus_2016_violent_extremism_579f5bba2729b.pdf)

Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2016, qasur në: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/grate-dhe-burrat-ne-kosove-20142015>

STRATEGJIA PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT QË SHPIE NË TERRORIZËM 2015 – 2020" [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA\\_parandalim\\_-\\_SHQIP.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf)

The citizens' views against violent extremism and radicalization in Kosovo. KCSS, 2016 [http://www.qkss.org/repository/docs/Raporti\\_final\\_CVE-Barometri\\_969038.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Raporti_final_CVE-Barometri_969038.pdf)

There was nobody to help me stop my son joining ISIS. The Guardian, 02/05/2016 <https://www.theguardian.com/world/2016/may/02/joining-isis-foreign-jihadis-syria-deradicalisation>

The Fitrah of Mankind – And the Near- Extinction of the Western Woman" Dabiq Magazine, 2015 edition pg.23

UNSCR 1325 "Women, Peace and Security"

What Became of Bethnal Green Girls Lured to Syria to Join IS? SkyNews, 2016, qasur në: <http://news.sky.com/story/what-became-of-bethnal-green-girls-lured-to-syria-to-join-is-10532801>

What Became Of Bethnal Green Girls Lured To Syria To Join IS?, Friday 12 August 2016

Winter.Ch. Përkthimi i "Gratë e Shtetit Islamik - Një Manifest për gratë nga Brigada Al - Khanssaa", 2015

### **Burimet online**

<https://www.youtube.com/watch?v=Ewu4bbLlajl>

<https://www.youtube.com/watch?v=jQUJGB6zJKs> <https://www.youtube.com/watch?v=NUQeOq16n-Q>

[https://www.youtube.com/results?search\\_query=thirrja%20per%20xihad%20%20shqip%20](https://www.youtube.com/results?search_query=thirrja%20per%20xihad%20%20shqip%20)

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

305-055.2(496.51)

316.385.26-055.2(496.51)

Jakupi, Rudinë

"Gratë në ekstremizmin e dhunshëm: mësimet e nxjerra nga Kosova" / Rudinë  
Jakupi, Vesë Kelmendi. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2017. -  
31 f. ; 21 cm.

1.Kelmendi, Vesë

**ISBN-978-9951-679-57-2**

ISBN 978-9951-679-57-2



9 789951 679572

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)